



RAPORT I AVOKATIT TË POPULLIT

**Në Vijim të Hetimit në lidhje me Ankesën e Sefer Goxhulit
kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës**

Nr. OMB-C-2022-04

28 shkurt 2023

PUBLIK

Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara të Kosovës (më tej në tekst 'Avokati i Popullit'), më 28 shkurt 2023,

pasi mori në shqyrtim ankesën e lartpërmendur, në përputhje me kompetencat e tij të përcaktuara në nenin 162(11) të Kushtetutës së Kosovës, nenin 34(9) të Ligjit për Dhomat e Specializuara ('DHS') dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ('ZPS') dhe rregullat 28 dhe 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('RRPP') mbi krijimin e Zyrës së Avokatit të Popullit si dhe në bazë të Procedurës së Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit ('Procedura e Ankesave'), të miratuar nga Avokati i Popullit më 12 shtator 2018,

pas shqyrtimit të kryer, nxjerr raportin e mëposhtëm:

I. ANKESA PARASHTRUAR AVOKATIT TË POPULLIT

1. Ankesa u regjistrua në Zyrën e Avokatit të Popullit më 13 dhjetor 2022.

2. Në pajtim me dispozitat e pjesës 14.3 të Procedurës së Ankesave të Zyrës së Avokatit të Popullit, në trajtimin e ankesave dhe hetimeve, për hir të mbrojtjes së interesave legjitime të ankuesit ose të një pale të tretë, Zyra e Avokatit të Popullit mund ta trajtojë si konfidencial informacionin konkret që përfshihet në një ankesë ose në një dokument apo material tjetër të marrë. Ankuesi ka konfirmuar se nuk ka kundërshtim që identiteti i tij të bëhet i ditur dhe Avokati i Popullit ka arritur në përfundimin se nuk ekzistojnë arsye bindëse për ta trajtuar si konfidencial informacionin e dhënë nga ankuesi.
3. Më 9 shkurt 2023, Prokurori i Specializuar dorëzoi përgjigjen e tij ndaj ankesës. Avokati i Popullit mban parasysh argumentet e parashtruara në përgjigjen e Prokurorit të Specializuar dhe në këtë vlerësim i ka kushtuar vëmendjen e duhur secilit prej tyre.

II. FAKTET

4. Pas shqyrtimit të korrespondencës së dorëzuar nga ankuesi, si dhe të parashtrimeve të Prokurorit të Specializuar, faktet mund të përmbliidhen si vijon.
5. Më 11 nëntor 2022, ankuesi u intervistua nga dy punonjës të ZPS-së.
6. Në fillim të intervistës, njëri prej punonjësve, gjatë leximit të një dokumenti, iu referua Republikës së Kosovës me fjalët '*Kosovo i Metohija*' ('Kosovë dhe Metohi').
7. Në atë moment, ankuesi nuk ngriti ndonjë kundërshtim dhe shqetësim në lidhje me përdorimin e shprehjes '*Kosovë dhe Metohi*', pasi u këshillua të mos e bënte këtë nga mbrojtësi i tij. Megjithatë, në fund të intervistës, ai shprehu shqetësimin e tij për përdorimin e kësaj shprehjeje në dokumentacion.

III. ANKESA

8. Në ankesë thuhet se përdorimi i këtij termi për t'iu referuar Republikës së Kosovës ishte thellësisht fyes, pasi ky është një term që përdoret nga Serbia kur i referohet Republikës së Kosovës në mënyrë përbuzëse.

9. Ai në vijim parashtron se përdorimi i një etiketimi të tillë për të përshkruar Kosovën është i neveritshëm dhe ngre shqetësime për konceptin që ka ZPS-ja për shtetin dhe njerëzit që përfaqëson. Ai pretendon se përdorimi i termit 'Kosovë dhe Metohi' nga ZPS-ja bie ndesh me nenin 1 të Kushtetutës së Kosovës.
10. Ankuesi më tej parashtron se ZPS-ja e ushtron veprimtarinë e saj në bazë të legjislacionit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe se objektivi i saj është administrimi i drejtësisë në emër të popullit të Kosovës.
11. Në përfundim të intervistës, ankuesi shprehu shqetësimet e tij për përdorimin e kësaj shprehjeje në dokumentacion dhe pretendon se hasi në mospërfilljen e juristëve të prokurorisë, të cilët dukej se nuk e kuptonin dhe/ose nuk u bëhej vonë për çka kishin thënë.
12. Ankuesi gjithashtu pretendon se përdorimi i termit nuk ishte thjesht rezultat i një gabimi gjuhësor nga ana e përfaqësuesit të ZPS-së, dhe vë në dukje faktin se përfaqësuesi në fjalë po e lexonte nga një dokument kur përdori këtë term.
13. Ankuesi kërkon marrjen e një sere masash për të korrigjuar problemet e ngritura në ankesën e tij, ndër të cilat ndërprerja e menjëhershme e përdorimit të këtij termi nga ZPS-ja dhe trajnimi i edukimi i punonjësve të DHSK-së/ZPS-së mbi origjinën e termit dhe arsyet pse ai konsiderohet fyes. Gjithashtu, ai kërkon që atij, Parlamentit Evropian dhe Departamentit Amerikan të Shtetit t'i dërgohet një shpjegim me shkrim mbi arsyet pse ishte përdorur ky term.

IV. PËRGJIGJJA E ZYRËS SË PROKURORIT TË SPECIALIZUAR

14. Më 9 shkurt 2023, ZPS-ja iu përgjigj Avokatit të Popullit.
15. ZPS-ja konfirmoi se ankuesi ishte intervistuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë, më 11 nëntor 2022.
16. ZPS-ja gjithashtu konfirmoi se termi "*Kosovo i Metohija*" ('Kosovë dhe Metohi'; '*Kosovo and Metohija*' në anglishte) ishte përdorur në intervistën me ankuesin dhe pranoi se kjo ishte bërë gabimisht.

17. ZPS-ja deklaroi se ky term nuk është pjesë e praktikës standarde të ZPS-së dhe nuk përdoret as në modelet standarde ose *pro forma* të dokumenteve që përdor ZPS-ja.
18. ZPS-ja hodhi poshtë pretendimin e ankuesit se punonjësit e saj ishin treguar mospërfillës ndaj ankesës së tij, të cilën ai ua kishte shprehur në përfundim të intervistës.
19. ZPS-ja informoi Avokatin e Popullit se pas intervistës, ish-in ndërmarrë disa hapa për të përcaktuar se si kishte ndodhur ky gabim dhe për të parandaluar përsëritjen e tij. Gjithashtu, punonjësve u ishin dhënë udhëzime të mëtejshme në lidhje me kontekstin e këtij termi.
20. ZPS-ja parashtron se ankesa duhet të rrëzohet *in limine* në bazë të rregullës 20(3)(b)-(c) dhe se masat ndreqëse të marra nga ZPS-ja u kishin dhënë zgjidhje të njëmendtë shqetësimeve të ngritura për aq sa ishte e arsyeshme dhe e lejueshme.

V. DISPOZITAT LIGJORE

21. Sipas rregullës 29(2)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, Avokati i Popullit mund të kryejë hetime në lidhje me ankesa të paraqitura prej cilitdo personi që pretendon shkelje të drejtave nga Dhomat e Specializuara ('DHS') ose nga ZPS-ja.
22. DHS-ja dhe ZPS-ja kanë detyrimin të veprojnë në përputhje me të drejtat e mishëruara në Kushtetutë dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të parapara në të njëjtin instrument, ndër të cilat Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut ('KEDNJ')¹ dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ('KNDCP')². Këto instrumente janë të detyrueshme si për DHS-në, ashtu dhe për ZPS-në.
23. Rregulla 28(2) e Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës ('RRPP') përcakton fushëveprimin e juridiksionit të

¹ Këshilli i Evropës, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, ndryshuar me Protokollin nr. 11 dhe 14 (4 nëntor 1950), ('KEDNJ').

² Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike ('KNDCP'), (16 dhjetor 1996), Seria e Traktateve të OKB-së Vëll. 999 ('KNDCP').

Avokatit të Popullit, i cili përfshin vetëm monitorimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e të drejtave themelore të personave që ndërveprojnë me DHSK-në dhe ZPS-në.

24. Sipas nenit 162(2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ('Kushtetuta e Kosovës,' ose 'Kushtetuta')³, DHS-ja dhe ZPS-ja duhet të veprojnë në përputhje me Kapitullin II të Kushtetutës. Në atë dispozitë konkretisht theksohet se të dy institucionet *"do të garantojnë të drejtat që i përmban Kapitulli II i Kushtetutës dhe në veçanti do të veprojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që janë të garantuara me Nenin 22 dhe në varshmëri me Nenin 55"*.
25. Bazuar në të drejtën materiale, Avokati i Popullit ka kompetencë të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut të përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës së Kosovës. Në veçanti, Avokati i Popullit vë në dukje dispozitat e nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës, të cilat përcaktojnë zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara prej marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare. Rrjedhimisht, KEDNJ-ja me Protokollin e saj dhe KNDCP-ja me Protokollin e saj kanë rëndësi të veçantë për punën e Avokatit të Popullit, sepse përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhen garantuar nga autoritetet publike në një shoqëri demokratike.

VI. VLERËSIMI I AVOKATIT TË POPULLIT

26. Para shqyrtimit të themelësisë së ankesës, Avokati i Popullit duhet të vendosë mbi pranueshmërinë e saj duke marrë parasysh dispozitat ligjore të zbatueshme dhe, në veçanti, kriteret e pranueshmërisë të shtjelluara në rregullën 29(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.
27. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit duhet së pari të përcaktojë nëse kërkesa i përmbush kriteret e pranueshmërisë, përpara se të kalojë në shqyrtimin e themelësisë së ankesës.
28. Avokati i Popullit vëren se në ankesë nuk ngrihet pretendimi për shkelje nga ZPS-ja të ndonjë të drejte të veçantë. Sidoqoftë, nga ankesa shihet qartë se ankuesi është shqetësuar dhe ofenduar nga përdorimi i termit 'Kosovë dhe Metohi' nga ZPS-ja gjatë intervistës së tij.

³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, qershor 2008 (me ndryshimet e vitit 2020).

29. Avokati i Popullit rikujton se nuk është parakusht që ankuesi të shfrytëzojë instrumente ose dispozita të veçanta të drejtave të njeriut në ankesën e tij, pasi çdo kriter i tillë do t'i vinte ankuesit para një detyrimi të papërligjshëm. Në rastet kur nuk ngrihen pretendime në lidhje me dispozita konkrete të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit bën vlerësimin e ankesave në kontekstin e Kapitullit II të Kushtetutës së Kosovës dhe neneve 28 dhe 29 të Rregullores.⁴
30. Avokati i Popullit pranon se përdorimi i termit 'Kosovë dhe Metohi' ishte fyes për ankuesin. Sidoqoftë, Avokati i Popullit mban parasysht se ky term ishte përdorur në mënyrë të paqëllimshme dhe gabimisht, dhe se ZPS-ja ndërmori disa hapa për të përcaktuar se si kishte ndodhur ky gabim, në mënyrë që të parandalohet përsëritja e tij. Gjithashtu, ZPS-ja mori masa për të siguruar që punonjësit e saj të kishin njohuri të plota për kontekstin e këtij termi. Pasi i shqyrtoi edhe një herë dispozitat e Kushtetutës së Kosovës, të instrumenteve përkatëse të të drejtave të njeriut, dhe në veçanti KEDNJ-së dhe KNDCP-së, Avokati i Popullit është bindur se ankesa nuk ka arritur të provojë se objekti i ankesës përfshihet në kuadrin e zbatimit të ndonjë prej të drejtave të përmendura.
31. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit rrëzon ankesën në bazë të rregullës 29(3)(b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave, pasi në të nuk provohet se ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga ZPS-ja.
32. Avokati i Popullit është bindur se ZPS-ja ka marrë masat e duhura për të siguruar që gabimi i bërë me përdorimin e shprehjes 'Kosovë dhe Metohi' të mos përsëritet.
33. Në lidhje me kërkesën e ankuesit për masa shtesë, Avokati i Popullit vëren se ZPS-ja është e pavarur në kryerjen e funksioneve të saj⁵ dhe se nuk ka bazë ligjore që ajo t'u raportojë subjekteve të ndryshme politike të jashtme, sikurse kërkohet nga ankuesi.

VII. PËRFUNDIM

Për arsyet e lartpërmendura, Avokati i Popullit arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur kundër Prokurorit të Specializuar duhet të rrëzohet në bazë të rregullës 29(3) (b) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave.

⁴ Raport i Avokatit të Popullit mbi Hetimin në lidhje me Ankesën e [REDAKTUAR] kundër Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës, nr. OMB-C-2021-05, 22 shtator 2022, publik, para. 85, 90.

⁵ Shih, ndër të tjera, nenet 3-5, 35 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

/nënshkrimi/

Pietro Spera,
Avokat i Popullit, Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Më 28 shkurt 2023
Në Hagë, Holandë.